

Të shtëna me armë në Prishtinë, plagoset një person



Foto: Ilustrim

Policia e Kosovës ka njoftuar se një person është plagosur si pasojë e të shtënave me armë zjarri.

Ngjarja ka ndodhur të premten rreth orës 11:00, në lagjen “Dardania” në Prishtinë.

“Sot rreth orës 11:00, policia ka marrë informatën për të shtëna me armë zjarri në lagjen Dardania në Prishtinë. Menjëherë pas marrjes së informatës policia ka dalë në vendin e ngjarjes dhe ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që konsistojnë në hetimin e rrethanave që karakterizojnë ngjarjen. Bazuar në të dhënat fillestare dyshohet se nga një person është plagosur dhe i njëjti është dërguar për tretman mjekësor”, ka thënë zëdhënësja e Policisë për rajonin e Prishtinës, Flora Ahmeti.

Sipas saj i dyshuari është identifikuar. “Hetuesit policor në koordinim me prokurorinë, po ndërmarrin veprimet hetimore për arrestimin e personit të dyshuar (i cili është identifikuar) si dhe ndriçimin e plotë të rasti”, ka theksuar Ahmeti.

© KOHA. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalin tonë zyrtar në Viber

#PLAGOSET #PRISHTINË

29 shtator 2023, 11:39

Shpërndaje në



Taboola Feed



Ja si mund të mbani në kontroll mykun e këmbëve në kushte shtëpie

Blog | Sponsored

Lexo më shumë



Ai studioi me mësim në distancë në universitetet Amerikane

Studime në distancë | Search Ads | Sponsored



Trajković: Radoiqi u nxor nga Banjaska nga “një dorë e fuqishme misterioze”

Politikania serbe Rada Trajković ka thënë se nënkryetari i Listës Serbe, Milan Radoiqi, u nxor nga fshati Banjaskë nga një “dorë misterioze”, e cila sipas saj, “ka fuqi si mbi palën ser...

Kohanes



Albania Prices of Unsold Laptops Might Suripse You

Unsold Laptops | Search Ads | Sponsored

TË NGJASHME



Plagoset një burrë në Prishtinë



Plagoset një person në Prishtinë